



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 575/1 Prot.

Tiranë, më 01.04.2021

**V E N D I M**

**Nr. 53, Datë 01.04.2021**

Mbështetur në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 05, datë 27.01.2021, e paraqitur nga Shoqata “Për Drejtësi Sociale”<sup>1</sup> kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, dhe me e-mail-in datë 31.01.2021, subjekti ankues informon se: “*F.S është banore e Bashkisë Elbasan dhe është e diagnostikuar me sëmundje kronike “astma bronchiale” dhe si pasojë, trajtohet me pension invaliditeti me nr.116712. Familja e saj përbëhet nga dy persona<sup>2</sup>, ajo dhe bashkëshorti i saj i cili është i regjistruar si punëkërkuar i papunë<sup>3</sup>. F.S ka dorëzuar dokumentacionin e duhur pranë zyrave të DRSSH Elbasan, për të përfituar rimbursimin e energjisë elektrike në masën e përcaktuar, si person me aftësi të kufizuar, por nuk e ka përfituar me argumentin se, Udhëzimi nr.01, datë 02.02.2015 i MF-së, MEI dhe MMSR “Mbi zbatimin e VKM nr. 8, datë 14.01.2015 për mbrojtjen*”

<sup>1</sup> Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, e regjistruar me Vendimin nr. 6599, datë 14.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është përfaqësuese me deklaratë, e F.S.

<sup>2</sup> Referuar Certifikatës Familjare, nr. 000942201, datë 03.12.2020 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile nr. 96, Elbasan.

<sup>3</sup> Referuar Vërtetimit datë 01.02.2021 të lëshuar nga Drejtoria Raronale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Elbasan, O.S është i regjistruar si punëkërkuar i papunë me numër regjistrimi në sistem 000000381470404, për periudhën nga data 10.01.2019 deri në datë 01.01.2021.

*e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 KWH për faturimin e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar, në pikën 2 përcakton se: “Familjet, që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuar, kur personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar së bashku me deklaratën sipas aneksit 1, duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror:....”. Sipas përcaktimit të mësipërm, rimbursimin e energjisë elektrike duhet ta përfitojnë vetëm personat me aftësi të kufizuar që janë kryefamiljarë. Por siç dihet, sipas modelit të certifikatës familjare në rubrikën kryefamiljar përcaktohen zakonisht meshkujt (bashkëshorti) dhe jo femrat. Pra, sipas përcaktimit ligjor, personat me aftësi të kufizuar të gjinisë femërore nuk mund të përfitojnë rimbursimin e energjisë elektrike edhe pse kryefamiljari mund të jetë si në rastin e F.S, i papunësuar dhe jo i vetpunësuar”.*

Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shqyrtimin e problematikës, pasi mendojnë se përcaktimi ligjor, që rimbursimin mund ta përfitojë vetëm kryefamiljari me aftësi të kufizuar, është trajtim i pabarabartë për personat me aftësi të kufizuar të gjinisë femërore.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>4</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar.

<sup>4</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 05, datë 27.01.2021 të Shoqatës “Për Drejtësi Sociale” u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 i Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 184/1, datë 02.02.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga institucionet përgjegjëse për ankesën e bërë nga Shoqata “Për Drejtësi Sociale”.

Me shkresën nr. 651/1, datë 12.02.2021, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka kërkuar nga Komisioneri verifikimin e faktit, nëse ankuesja është përfituese e skemës së aftësisë së kufizuar, nga programi i përkujdesit social.

Me shkresën nr. 871/1, datë 16.02.2021, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Me kërkesën nr. 375, datë 06.02.2019, e interesuara ka kërkuar përsëritjen e invaliditetit dhe ka deklaruar se familja e saj përbëhet nga dy anëtarë. Në bazë të të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, përbërja familjare, në datën e paraqitjes së kërkesës, ka rezultuar me 6 anëtarë dhe 3 nga anëtarët e familjes, kanë rezultuar të punësuar. F.S, në aplikimin online të datës 17.12.2020, ka kërkuar rivlerësim KMCA, por në formatin e përcaktuar, nuk ka kërkuar kompensim për energjinë elektrike, ndërsa në aplikimin online të datës 10.02.2020, ka kërkuar rishqyrtim KMCA dhe ka bashkëngjitur vetëm dokumentet mjekësorë. Gjendja aktuale e çertifikatës, me datë 08.02.2021, rezulton me dy pjesëtarë, por nuk konstatojmë aplikim për kompensim për energjinë elektrike, në emër të F.S. Sa më sipër, ankuesja mund të aplikojë online në portalin e-albania, duke deklaruar numrin e kontratës dhe DRSSH Elbasan, do të shqyrtojë kërkesën dhe do të informojë zyrtarisht të interesuarën”.*

Me shkresën nr. 363/1, datë 25.02.2021, Shërbimi Social Shtetëror, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi në regjistrin elektronik të aftësisë së kufizuar si dhe nga komunikimi me DRSSH Elbasan rezulton se F.S është përfituese e pensionit të invaliditetit nga skema e sigurimeve shoqërore Elbasan. Nga skema e mbrojtjes sociale përfiton vetëm pagesë shtesë mbi invaliditetin në masën 3300 lekë në muaj të cilën e përfiton pranë zyrës së ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore pranë Bashkisë Elbasan. Të gjitha përfitimet e tjera (përfshirë dhe kompensimin e energjisë elektrike) që i takojnë për shkak të invaliditetit të punës i përfiton pranë DSSH Elbasan”.*

- Me shkresën nr. 184/5, datë 11.03.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga DRSSH Elbasan lidhur me shqyrtimin e aplikimit të F.S për kompensimin e energjisë elektrike.

Me shkresën nr. 3770/1, datë 16.03.2021, DRSSH Elbasan, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Ka trajtuar dosjen e ankueses dhe ka llogaritur diferencat nga data e paraqitjes së qytetares, datë 18.02.2021. Ndryshimet janë pasqyruar në sistem, dhe duke qenë se muaji aktual është i gjeneruar, shtesa kreditore në vlerën 1717 lekë do të kryhet në muajin pasardhës”.*

Me shkresën nr. 1840/1, datë 19.03.2021, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“DRSSH Elbasan me vendim të datës 11.03.2021, bazuar në aplikimin online të datës 18.02.2021, i ka llogaritur F.S kompensimin e energjisë elektrike në masën 640 lekë në muaj sipas VKM nr. 565, datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, si dhe kompensimin e energjisë elektrike në masën 648 lekë në muaj sipas VKM nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj” që nga data 18.02.2021. Në zbatim të pikës 3, të nenit 62, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, DRSSH Elbasan i ka llogaritur F.S shtesën kreditore në masën 1770 lekë për periudhën nga 18.02.2021 – 31.03.2021, shumë e cila do të gjenerohet së bashku me këstin mujor të pensionit të invaliditetit të muajit prill 2021 pranë qendrës pagueuse nr. 5 Elbasan”.*

Informacioni i dërguar nga ISSH dhe DRSSH Elbasan, iu referua Shoqatës “Për drejtësi sociale”, e cila me e-mail-in datë 23.03.2021, ka falenderuar Komisionerin për zgjidhjen efektive të ankesës në emër të F.S.

Neni 33, pika 9 e Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ka parashikuar se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”.* Komisioneri vlerëson frymën bashkëpunuese të ISSH-së dhe DRSSH Elbasan, lidhur me marrjen e masave për zgjidhjen me efektivitet të problematikës së paraqitur nga F.S.

Për sa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se kërkesa e F.S është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim, në drejtim të përfitimit të kompensimit të energjisë elektrike nga F.S.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “b”, nenin 33, pikat 9 e 10, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 05, datë 27.01.2021, paraqitur nga Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**